


CNC NESTING

RK-2128ALL-PREMIUM



HAIXUN SOFTUER I LICENCUAR

Softuer i sofistikuar që ju mundëson dizajnimin dhe optimizimin e shpejtë dhe efikas të prodhimit, ofron pamje në 3D dhe mundësinë për të marrë oferta të menjëhershme me çmime të detajuara. Ky softuer është i përputhshëm me CNC shpuesat nga programi RADEK.



MUNDËSI PËRMIRËSIMI

Ngarkimi automatik i panelit, një pajisje me jastëkë vakum të vendosura në vetë urën dhe që lejon marrjen e materialit nga tavolina e ngritjes. Shkarkimi automatik i panelit, një pajisje që ndodhet gjithashtu në vetë urën dhe lejon lëvizjen e copave tashmë të përpunuara në një shirit transportieri të veçantë që i merr ato.

Makina CNC nesting ju jep maksimumin për buxhetin tuaj, është e njohur për saktësinë e saj të lartë, shpejtësinë, produktivitetin, përdorimin fleksibël në prerje, gdhendje dhe shpime, si dhe mundësinë e përmirësimit me një pajisje ngarkimi dhe shkarkimi panelesh për automatizim shtesë të makinës.



MOTORI INDUSTRIAL 9KW

Prodhimi, dizajni dhe pjesët shoqëruese të motorit janë 100% të njëjta me cilësinë e prodhuesve më të njohur ndërkombëtarisht. Motori ka 24,000 rrotullime në minutë dhe ftohje me ajër, e cila mundëson përpunim të pandërprerë të të gjitha llojeve dhe trashësive të materialeve.



URA E KONSTRUKSIONIT MASIV

I ndërtuar nga profilet drejtkëndëshe të çelikut, i përmirësuar konstruktivisht dhe i forcuar më tej në pjesën e brendshme. Tipi i konstruksionit të urës siguron një nivel të lartë të forcës, qëndrueshmërisë dhe garanton precizitet të lartë. Cilësia e tij është ndjeshëm më e mirë se ajo e urave të tjera në treg.



MOTORËT SERVO ME SAKTËSI TË LARTË

Motorët servo të dizajnuar veçanërisht për kërkesa të larta dhe performanca, në kombinim me reduktues të njohur japonezë. Garantojnë pozicionim të saktë të urës dhe të boshtit pa devijime dhe gabime, si dhe shpejtësi të lartë lëvizjeje deri në 30 metra në minutë. Cilësi e prouar dhe stabilitet në punë, edhe në kushte të vështira industriale.



POMPË VAKUMI

Makina është e pajisur me dy pompe vakumi me fuqi prej 7,5 kW dhe ftohje me ajër. Kapaciteti i secilës pompë vakumi është 550 m³ në orë, që mundëson thithje të lartë, madje edhe për panele të vogla. Për më tepër, thithja është forcuar nga përdorimi i ruleve pneumatikë, që e shtypin panelin.



TAVOLINA E PUNËS

Tavolina e punës e makinës është e dizajnuar nga plastika speciale rezistente ndaj shpenzimit për përdorim me një pompë vakumi. Për më tepër, ka shina alumini të integruar "T" të cilat lejojnë fiksimin manual të copave të punës duke përdorur shtrënguese.



LËVIZJE NËPËR BOSHTIN Z DHE Y

Lëvizja e boshtit kryhet nëpërmjet kushinetave lineare (30 mm dhe 25 mm) dhe binarëve me dhëmbëza të markës shumë të njohur HIWIN nga Tajvani, i cili është dëshmuar të jetë sistemi më i mirë dhe më efikas i lëvizjes për shumicën e makinerive CNC. Lejon punë të pandërprerë, me nivel të ulët zhurme dhe reduktim të ndjeshëm të të gjitha ngarkesave shtesë.

Sipërfaqja e punës	2100x2800x250mm
Fuqia e motorit kryesor	9kW
Numri i rrotullimeve i motorit kryesor	24.000rpm
Lloji i ftohjes së motorit kryesor	Me ajër
Lloji i motorit për lëvizje	Motorët servo
Fuqia e motorit për lëvizje	1.5kW
Tavolina e punës	Tavolinë vakumi + binarë alumini
Fuqia e pompës vakumi	7.5kW (x2)
Kapaciteti i pompës vakumi	550m³/h
Tipi i ftohjes së pompës vakumi	Me ajër
Numri i zonave të vakumit	x8
Sistemi operativ	Tajvan LNC
Shpejtësia e përpunimit	0-30m/min
Tipi i mbështjellësit të motorit kryesor	ER32
Diametri i mbajtësit të mbështjellësit	2-25mm
Dimensionet e makinës	11800x3000x2400mm
Pesha	4500kg



LËVIZJE NËPËR BOSHTIN Z

Boshti Z konsiderohet të jetë më i ngarkuari dhe për këtë arsye është zbatuar një bosht shtesë, i cili mundëson saktësi të jashtëzakonshme, fërkim të ulët të elementeve, mbrojtje maksimale kundër shpenzimit të shpejtë, si dhe parandalim të ngrohjes së elementeve që përjetojnë fërkim gjatë punës së makinës.



SISTEMI OPERATIV

Sistemi operativ LNC nga një markë shumë e njohur tajvaneze. Ofron qasje të lehtë dhe të organizuar në të gjitha funksionet e makinës.